



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 1784/6 prot.

Pogradec, më 21.04.2026

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues: **“PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË AKSIONEVE TË BASHKISË POGRADEC NGA SHOQËRIA “KRWM” SH.A TEK SHOQËRIA “AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE” SH.A**

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)

Nr. i i doc Shoqëuese 2 (dy)

Nr. i kopjeve: 5 (Pesë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____ / ____ /2026

PËR

“MIRATIMIN E KALIMIT TË AKSIONEVE TË BASHKISË POGRADEC NGA SHOQËRIA “KRWM” SH.A TEK SHOQËRIA “AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE” SH.A

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, në VKM Nr. 37, datë 21.01.2026 “Për përcaktimin e organizimit të brëndshme të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a si dhe referuar shkresës me Nr.44/2 Prot. Datë 30.03.2026, me lëndë “Njoftim për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM”sh.a tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a të paraqitur nga Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalimin e aksioneve që Bashkia Pogradec zotëron në shoqërinë “KRWM”sh.a me NUIS: **K842270010**, tek shoqëria “**Agjencia Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve**” sh.a.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike dhe administrative për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë:
 - a) nënshkrimin e aktit të transferimit të aksioneve;



- b) përfaqësimin e Bashkisë Pogradec në organet e shoqërisë "KRWM" sh.a;
 - c) dhënien e çdo autorizimi të nevojshëm për depozitimin dhe regjistrimin e ndryshimeve përkatëse.
3. Ngarkohet Përfaqësuesi i Bashkisë Pogradec në Asamblenë e Aksionarëve të shoqërisë "KRWM" sh.a., të përfaqësojë Bashkinë me të drejtë vote në cdo vendimarrje që lidhet me zbatimin e transferimit të aksioneve sipas këtij vendimi dhe me pasqyrimin e tij në regjistrat publikë përkatës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 1788 / Prot.

Pogradec, më 21.04.2026

RELACION

PËR

“MIRATIMIN E KALIMIT TË AKSIONEVE TË BASHKISË POGRADEC NGA SHOQËRIA “KRWM” SH.A TEK SHOQËRIA “AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE” SH.A

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Shoqëria “KRWM” sh.a. është një shoqëri aksionare e regjistruar me NUIS: **K842270010**, me seli në Maliq, kapital të regjistruar **3,740,300 lekë** dhe **226 aksione**, me objekt veprimtarie: “mbledhjen, transportin, administrimi, depozitim e mbetjeve bashkikake dhe komunale, industriale, mbetjeve të spitaleve, ndërtimeve, sistemit të ujrave të zeza, kanalizimit, rezervuareve, mbetjeve bujqesore, mbetjeve voluminoze bashkiake dhe komunale”.

Sipas ekstraktit historik të regjistrimit tregtar, Bashkia Pogradec zotëron aktualisht 26 % të aksioneve të shoqërisë KRWM sh.a. Nga historiku i regjistrimit rezulton se kjo përqindje lidhet me strukturën aktuale të aksioneve të shoqërisë, e konsoliduar pas ndryshimeve të regjistruara në vitin **2016**.

Ky projekt mbështetet në këto akte:

- **Ligji nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**, i cili përcakton AKEM-in si institucion me rol qendror në bashkërendimin, zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës së rrjetit kombëtar të impianteve të trajtimit të mbetjeve, si dhe parashikon se AKEM-i mund të krijojë shoqëri dhe degë.
- **VKM nr. 37, datë: 21/01/2026**, sipas së cilës **AKEM sh.a.** është shoqëri aksionare me kapital **100% shtetëror** dhe shteti përfaqësohet si pronar i aksioneve të saj nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

Kuadri i ri ligjor dhe nënligjor i menaxhimit të integruar të mbetjeve synon konsolidimin institucional dhe funksional të infrastrukturës së trajtimit fundor të mbetjeve nën koordinimin e AKEM-it. Ligji i ri i jep AKEM-it funksione të qarta për zhvillimin dhe administrimin e rrjetit kombëtar të impianteve të trajtimit, ndërsa VKM nr. **37/2026** e vendos AKEM sh.a. në një regjim të plotë pronësie shtetërore dhe nën përfaqësimin e ministrisë përgjegjëse për mjedisin.



Në këtë kuadër, kalimi i aksioneve të bashkive në KRWM sh.a. tek AKEM sh.a. synon:

- unifikimin e pronësisë dhe të vendimmarrjes mbi infrastrukturën fundore rajonale të mbetjeve;
- harmonizimin e shoqërisë KRWM sh.a. me arkitekturën e re institucionale të parashikuar nga ligji nr. 57/2025;
- rritjen e eficiencës së menaxhimit, financimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së trajtimit të mbetjeve.

Bazuar në argumentat e mësipërm, Këshilli Bashkiak Pogradec propozohet të vendosë:

1. miratimin e kalimit tek **Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a.** të të gjitha aksioneve që **Bashkia Pogradec** zotëron në **KRWM sh.a.**;
2. autorizimin e **Kryetarit të Bashkisë Pogradec** për nënshkrimin e aktit/akteve përkatëse të transferimit;
3. autorizimin për përfaqësim në Asamblenë e Aksionarëve të KRWM sh.a. për të votuar në përputhje me këtë vendim;
4. ngarkimin e strukturave përkatëse për ndjekjen e procedurave administrative, korporative dhe të regjistrimit në QKB.

Për sa më sipër, vlerësohet se miratimi i kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga KRWM sh.a. tek AKEM sh.a., është një masë në përputhje me drejtimin e ri institucional të përcaktuar nga ligji nr. 57/2025 dhe VKM nr. 37/2026, dhe i shërben organizimit më efektiv të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Për sa më sipër, kërkohet miratimin e këtij projekt- vendimi.

Bashkangjitur:

1. Shkresa me Nr. 44/2 Prot. Datë 30.03.2026, me lëndë "Njoftim për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria "KRWM"sh.a tek shoqëria "Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve" sh.a të paraqitur nga Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë.

Duke pasur besim të plotë, ju ftojme të miratoni projekt-vendimin e paraqitur.

Ju faleminderit!

Konceptoi: I. BERBERI

Pranoi: E. KAMOLLI

Miratoi: A. KANINA

Konfirmoi: D. BABASULI

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 1789 Prot
6

Pogradec, më 21.04.2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

“MIRATIMIN E KALIMIT TË AKSIONEVE TË BASHKISË POGRADEC NGA
SHOQËRIA “KRWM” SH.A TEK SHOQËRIA “AGJENCIA KOMBËTARE E
EKONOMISË SË MBETJEVE” SH.A

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.



Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Proedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: “**Akt normativ nënligjor**” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

- a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
- b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt administrativ kolektiv, i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Proedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij dhe i drejtohet një subjekti të miëpërcaktur, nuk ka karakter të përgjithshëm dhe abstrakt si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik-social në Bashkinë e Pogradeci i cili synon ,që me kalimin e aksioneve nga shoqëria aksionere “KRWM” sh.a tek “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë e Mbetjeve” sh.a (“AKEM”sh.a) do të zbatohen më mirë politikat ekonomik-sociale, në kuadrin e mirë menaxhimit të mbetjeve urbane, duke qenë se ky i fundit është një institucion me kapital 100% shtetëror, ku shteti përfaqësohet si pronar i aksioneve nga Ministria përgjegjëse për mjedisin.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës administrative kolektiv dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: I. BERBERI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë

Data: 30/03/2026

ADMINISTRIMI I MBETJEVE QARKU KORÇË
ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËMR. 1497
02.03.2026

Nr. 44/2 Prot

Maliq më: 20/03/2026



Lënda: Njoftim për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria "KRWM" sh.a. tek shoqëria "Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve" sh.a.

KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec

Për dijëni:

Z. ILIR XHAKOLLI
KRYETAR**BASHKIA POGRADEC***Adresa: Bulevardi "Reshit Çollaku", Pogradec*

Në vijim të kuadrit të ri ligjor të përcaktuar nga ligji nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 37, datë : 21/01/2026, "Për përcaktimin e organizimit të brendshëm të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve sh.a.", me anë të të cilit "AKEM" sh.a. përcaktohet si shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, ku shteti përfaqësohet si pronar i aksioneve nga ministria përgjegjëse për mjedisin, ju përcjellim këtë njoftim për shqyrtimin dhe miratimin e kalimit të pjesëmarrjes aksionare nga shoqëria "KRWM" sh.a. tek "AKEM" sh.a.

Shoqëria "KRWM" sh.a., me NUIS: K842270010, është shoqëri aksionare me kapital të regjistruar : 3,740,300 lekë, me : 226 aksione, dhe me strukturë aksionare të përbërë nga bashkitë : **Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Kolonjë dhe Pustec.**

Sa më sipër, kërkohet që Këshilli Bashkiak Pogradec, në ushtrim të kompetencave të tij, të marrë në shqyrtim dhe, sipas vlerësimit të tij, të miratojë projektvendimin përkatës për kalimin e aksioneve që kjo bashki zotëron, si pjesë e procesit të riorganizimit institucional të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRWIM
Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë



Për efekt të vijueshmërisë së procedurës, pas miratimit nga këshilli bashkiak, lutemi të na përcillet kopje e vendimit të miratuar, së bashku me dokumentacionin shoqërues përkatës, me qëllim ndjekjen e mëtejshme të procedurave juridike, korporative dhe të regjistrimit.

Konceptoi : **R.Neziri** (Jurist dhe Burime Njerrëzore)

Maliq më: 30 / 10 / 2026

TITULLARI I INSTITUCIONIT
Eriseld JONUSLLARI